

# RAPORT I PYETËSORIT ONLINE

KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE TË KOSOVËS LIDHUR  
ME INTEGRIMIN EVROPIAN DHE BE-NË





# RAPORT I PYETËSORIT ONLINE

KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE TË KOSOVËS LIDHUR  
ME INTEGRIMIN EVROPIAN DHE BE-NË

E drejta e autorit © 2021 . Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237  
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Përgatitur nga:** Agnesa Haxhiu

**Dizajn dhe faqasje:** Envision

Ky raport është pjesë e projektit " "Promovimi i vlerave të përbashkëta evropiane" që financohet nga Komisionin Evropian dhe implementohet nga KDI/TIK, Transparency International Hungaria, Transparency International Maqedonia dhe organizata Forumi i Ekspertëve nga Rumania.

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Komisionit Evropian.

# PËRMBAJTJA

HYRJE .....	6
METODOLOGJIA.....	7
QËNDRIMET E QYTETARËVE KARSHI IDENTITETIT KOMBËTAR DHE ATIJ EVROPIAN .....	8
QËNDRIMET E QYTETARËVE PËR VLERAT QË PROMOVON BE-JA .....	10
PËRPARËSITË DHE MANGËSITË NGA ANËTARËSIMI NË BE .....	12
QASJA E BE-SË NDAJ KOSOVËS NË RRUGËN DREJT ANËTARËSIMIT .....	14
QËNDRIMET E QYTETARËVE LIDHUR ME PRIORITETET E BE-SË PËR SHTATË VITET E ARDHSHME.....	16
ROLI I INSTITUCIONEVE TË BE-SË NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË VENDET QË SYNOJNË ANËTARËSIMIN .....	18
QËNDRIMET RRETH REFERENDUMIT PËR ANËTARËSIMIN NË BE .....	21



# HYRJE

Projekti me emrin 'Vlerat e Përbashkët Evropiane' ka për qëllim inicimin e një diskutimi për çështje në lidhje me integrimin Evropian dhe Bashkimin Evropian. Financuar nga Komisioni Evropian nën programin Evropa për Qytetarët, projekti është një bashkëpunim midis Institutit Demokratik të Kosovës Transparency International në Hungari, Forumit të Ekspertëve të Rumanisë dhe Transparency international në Maqedoni. Për këtë qëllim, të katër organizatat kanë krijuar një pyetësor anonim online, për herë të parë njëkohësisht në këto katër vende, lidhur me qëndrimet e qytetarëve të këtyre shteteve për integrimin evropian e në veçanti për Bashkimin Evropian.

Duke marrë parasysh faktin që të katër vendet ku është zhvilluar pyetësori kanë kontekst të ndryshëm sa i përket çështjes së integritimit, ku dy prej tyre (Hungaria dhe Bullgaria) janë anëtare të BE-së, Maqedonia ka marrë statusin e kandidatit ndërsa Kosova ka nënshkruar vetëm zbatimin e MSA-së, pyetjet janë formuluar duke ju përshtatur kontekstit të secilit shtet.

Më anë të këtij pyetësori është synuar që të merret këndvështrimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me procesin e integritimit evropian, sa janë të informuar qytetarët mbi atë se çfarë ofron BE-ja në termat ekonomike, sociale, politike e kulturore dhe mendimin e tyre mbi parimet dhe vlerat kryesore mbi të cilat është ngritur dhe funksionon Bashkimi Evropian.





# METODOLOGJIA

Sa i përket metodologjisë hulumtuese, është përzgjedhur tipi kuantitativ i hulumtimit, përkatësisht pyetësor në formatin online. Hulumtimi ka përfshirë 500 të anketuar, prej tyre 56.6 për qind burra dhe 40.6 për qind gra kurse rreth 3 për qind kanë preferuar që të mos deklarohen sa i përket gjinisë së tyre. Sa i përket nivelit të shkollimit, 41 për qind e të anketuarave kanë qenë me nivel të shkollimit

Bachelor, 28.2 për qind të nivelit Master, me nga 10.6 për qind më shkollim profesional dhe gjimnaz, 6.4 për qind në studime pasuniversitare dhe 3.2 për qind me shkollë fillore. Për sa i takon të anketuarve në bazë të vendbanimit, 78 për qind e tyre kanë qenë nga zonat urbane dhe 22 për qind nga zonat rurale. Ky hulumtimi është zhvilluar nga data 29 prill deri më 26 maj të vitit 2021.






# QËNDRIMET E QYTETARËVE KARSHI IDENTITETIT KOMBËTAR DHE ATIJ EVROPIAN

Për qytetarët e Kosovës, marrë parasysh diskursin kombëtar që ekziston në Kosovë, identiteti kombëtar është më i rëndësishëm sesa ai evropian. Në pyetjen se cilin identitet është më i rëndësishëm për ju ai kombëtar apo ai evropian, rreth gjysma e respondentëve apo shprehur në përqindje rreth 50% e tyre e vlerësojnë identitetin

kombëtar si më të rëndësishëm për ta. Në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve gjegjësisht rreth 40% e tyre kanë deklaruar se edhe identiteti kombëtar edhe ai evropian janë të së njëjtës rëndësi për ta. Ndërkaq vetëm rreth 10% e tyre e shohin identitetin e tyre evropian si më të rëndësishëm.








**Fig.1** Rëndësia e identitetit kombëtar dhe atij evropian




# QËNDRIMET E QYTETARËVE PËR VLERAT QË PROMOVON BE-JA

Vlerat e demokracisë, sundimi i ligjit, mbrojtja e të drejtave të njeriut, lëvizja e lirë e punës dhe kapitalit u shënuan si shumë të rëndësishme nga shumica dërrmuese e respondentëve, ndërsa liria e mediave u perceptua si vetëm pak më pak e rëndësishme. Megjithatë, sipas përgjigjeve, kjo është në përpjesëtim të kundërt me vlerat që

Bashkimi Evropian është në gjendje të garantojë. Nëse shohin se si janë përgjigjur respondentët në pyetjen se sa është në gjendje BE-ja të mbrojë këtë vlerë, respondentët e kanë vlerësuar si mesatare potencialin që ka BE-ja për të mbrojtur demokracinë, lëvizjen e lirë të punës dhe kapitalit, lirinë e shtypit dhe sundimin e ligjit (shih fig.3).





**Fig.2** Rëndësia dhe implementimi i vlerave evropiane






# PËRPARËSITË DHE MANGËSITË NGA ANËTARËSIMI NË BE

Me anë të këtij pyetësoari, qytetarët janë pyetur lidhur me këndvështrimin e tyre për përparësitë dhe mangësitë që mund të ketë anëtarësimi i Kosovës në BE. Në pyetjen se deri në çfarë mase mendoni se do të përfitojë Kosova nga anëtarësimi në BE nga shkalla 1 deri në 5, ku 1 do të thotë aspak dhe 5 shumë mbi 67 % e respondentëve konsid-

erojnë që Kosova do të përfitonte shumë nga ky anëtarësim duke vlerësuar me shkallën 4 dhe 5. Ndërkaq rreth 23 % e tyre mendojnë që deri diku do të kishte përfitime, kurse vetëm diku rreth 9% konsiderojnë që anëtarësimi në BE Kosovës do të sillte pak ose aspak përfitime.




**Fig.3** Vlerësimet lidhur me përfitimet e Kosovës nga anëtarësimi në BE





Por kur janë pyetur mbi mangësitë eventuale nga anëtarësimi në BE, në këtë rast nëse anëtarësimi do ta kufizonte sovranitetin e Kosovës, rreth 39% e tyre konsiderojnë që një proces i tillë nuk do të kishte ndikim në sovranitetin e vendit. Një pjesë tjetër e konsiderueshme e respondentëve apo

shprehur në përqindje rreth 33% e tyre mendojnë që anëtarësimi deri diku do të kufizonte sovranitetin ndërsa një pjesë e respondentëve prej rreth 28% e tyre vlerësojnë që anëtarësimi potencial do të kishte ndikim në sovranitetin e vendit.



**Fig.4** Vlerësimet lidhur me ndikimin që mund të ketë anëtarësimi në sovranitetin e vendit





# QASJA E BE-SË NDAJ KOSOVËS NË RRUGËN DREJT ANËTARËSIMIT

Ndonëse qytetarët e Kosovës kanë nivel të lartë të besimit në perspektivën evropiane, nga matje e opinionit publik përmes këtij pyetësi shohim se ata vlerësojnë që BE-ja nuk e ka përkthyer këtë besim të qytetarëve në veprime konkrete. Në pyetjen se sa mendoni që ka bërë BE-ja për të nxitur rrugën e anëtarësimit të Kosovës drejt BE-së, më shumë se gjysma e të anketuarve apo shprehur në

përqindje rreth 52% e tyre konsiderojnë që BE-ja ka bërë shumë pak veprime për të nxitur rrugën e anëtarësimit të Kosovës në BE. Një përqindje po ashtu e lartë rreth 29% e vlerësojnë si mesatare përpjekjet e BE-së për të shtyrë përpara rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit, kurse vetëm 18% e respondentëve mendojnë që BE-ja ka bërë shumë për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit të Kosovës.





Fig.5 Vlerësimet për punën e BE-së në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës





Pavarësisht faktit që qytetarët e Kosovës mendojnë që BE-ja nuk ka bërë shumë për ta shtyrë përpara procesin e anëtarësimit të Kosovës, megjithatë ata vlerësojnë që ndikimi i saj në formësimin e politikave në Kosovë ka qenë i madh. Rreth 47 % e respondentëve mendojnë që ndikimin i BE-së në formësimin e politikave në Kosovë ka qenë

i madh, një pjesë po ashtu e konsiderueshme e tyre apo shprehur në përqindje rreth 30% e tyre e vlerësojnë si mesatar ndikimin e BE-së kurse një përqindje më e vogël prej 21 % e respondentëve konsiderojnë që ndikimi i saj ka qenë relativisht i vogël ose nuk pasur fare ndikim.



**Fig.6** Vlerësimet për ndikimin e BE-së në politikat e Kosovës





# QËNDRIMET E QYTETARËVE LIDHUR ME PRIORITETET E BE-SË PËR SHTATË VITET E ARDHSHME

Përmes këtij pyetësoi, të anketuarit kanë pasur mundësi të deklarojnë mendimet e tyre lidhur me prioritetet e BE-së për vitet 2021 - 2027, duke zgjedhur më shumë se një opsion nga të gjitha opsionet e dhëna në pyetësoi. Në përgjigjet e marra nga respondentët, shohim se një pjesë e madhe, rreth 70 % gjegjësisht 56% e tyre e kanë konsideruar zbatimin e një "Evropë më Sociale"

dhe përmbushjen e objektivave të klimës dhe ambientit si më të rëndësishmet në mesin e prioritetëve që ka BE-ja në shtatë vitet e ardhshme. Ndërkaq edhe prioritetet e tjera si inovacioni e digjitalizimi, transporti strategjik dhe zhvillimi i qëndrueshëm urban kanë marrë përkrahje nga respondentët (shih fig.8).





252

(50.4%)

NJË EVROPË MË E MENÇUR, PËRMES INOVACIONIT, DIGJITALIZIMIT, TRANSFORMIMIT EKONOMIK DHE MBËSHTETJES PËR BIZNESET E VOGLA DHE TË MESME

282

(56.4%)

NJË EVROPË MË E GJELBËR, PA KARBON, QË E ZBATON MARRËVESHJEN E PARISIT DHE INVESTON NË TRANZICIONIN E ENERGJISË, BURIMET E RIPËRTËRITSHME DHE LUFTËN KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

161

(32.2%)

NJË EVROPË MË E LIDHUR, ME TRANSPORT STRATEGJIK DHE RRJETE DIGJITALE

349

(69.8%)

NJË EVROPË MË SOCIALE, QË E ZBATON SHTYLLËN EVROPIANE TË TË DREJTAVE SOCIALE DHE E MBËSHTET PUNËSIMIN CILËSOR, ARSIMIN, SHKATHTËSITË, PËRFSHIRJEN SOCIALE DHE QASJEN E BARABARTË NË KUJDES SHËNDETËSOR

214

(42.8%)

NJË EVROPË MË AFËR QYTETARËVE, QË I MBËSHTETË STRATEGJITË ZHVILLIMORE QË UD-HËHIQEN NGA VENDASIT DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM URBAN NË TËRË BE-NË.

**Fig.7** Qëndrimet lidhur me prioritetet e BE-së për vitet 2021-2027




# ROLI I INSTITUCIONEVE TË BE-SË NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË VENDET QË SYNOJNË ANËTARËSIMIN

Përmes këtij pyetësoi, të anketuarit kishin mundësi të vlerësonin rolin e Bashkimit Evropian nga disa aspekte të ndryshme, e një ndër to ishte lidhur me atë se sa mund të bëjnë institucionet e Bashkimit Evropian për të parandaluar korrupsionin në vendet që aspirojnë anëtarësimin. Një përqindje e lartë e respondentëve, rreth 46 % e tyre konsiderojnë që institucionet e BE-së kanë

potencialin që të bëjnë shumë për t'i ndihmuar shtetet që aspirojnë anëtarësimin sikurse Kosova, në luftën kundër korrupsionit. Rreth 30% e tyre e vlerësojnë si mesatar ndikimin që mund të këtë BE-ja në luftën kundër korrupsionit në Kosovë, ndërsa një pjesë tjetër e respondentëve, rreth 24% e tyre mendojnë që BE-ja mund të bëjë fare pak ose aspak në këtë drejtim.






**Fig.8** Vlerësimet për rolin që mund të ketë BE-ja për të luftuar korrupsionin në vendet që synojnë anëtarësimin

Ndërsa kur janë pyetur lidhur me qëndrimin e tyre për anëtarësimin e Kosovës në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian, pjesa dërrmuese e respondentëve ose shprehur në përqindje rreth 74% e tyre i kanë dhënë mbështetje një veprimi të tillë.

Kurse një përqindje e vogël prej rreth 10% konsiderojnë që Kosova nuk do të duhej të anëtarësohej në këtë Zyrë, ndërsa rreth 15% e respondentëve nuk kanë mendim për këtë çështje.





**Fig.9** Vlerësimet për anëtarësim në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian






# QËNDRIMET RRETH REFERENDUMIT PËR ANËTARËSIMIN NË BE

Ekziston një pajtim i gjithmbarshëm që qytetarët e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të tregojnë mbështetje tejet të madhe për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, ku pothuajse në secilën matje të opinionit publik mbi 50% e qytetarëve mbështesin synimin e vendit të tyre për anëtarësim në BE.

Sa i përket anëtarësimin në BE, në mesin e popujve të Ballkanit perëndimor, kosovarët vazhdojnë të

jenë ndër mbështetësit më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor. Nga të dhënat e këtij pyetësi del që rreth 78 % e respondentëve kanë deklaruar se do të votonin pozitivisht në rast të një referendumi të mundshëm lidhur me anëtarësimin në BE. Është një përqindje fare e vogël, vetëm 10% e tyre që kanë deklaruar se në rast të një referendumi për integrim në BE do të votonin negativisht, kurse rreth 11% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje rreth kësaj pyetje.





**Fig.10** Vlerësimet për anëtarësim në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian





